VENDIM
Nr. 145, datë 25.6.2018

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E ALOKIMIT TË SHOQËRISË "FURNIZUESI I TREGUT TË LIRË" SHA, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "ç", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 4, pika 1, germa "d"; nenit 10, pikat 1 dhe 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, dhe nenit 19 pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 25.6.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për licencimin e shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 7818 prot., datë 27.4.2018, protokolluar me tonën nr. 355 prot., datë 30.4.2018, OSHEE sh.a., ka përcjellë dokumentacionin për transferimin e licencave dhe licencimin e shoqërive të kontrolluara nga ana e saj. Ndër to, është edhe dokumentacioni i shoqërisë "Furnizuesi i Tregut të Lirë" sh.a. (FTL sh.a.), për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 2/1 prot., datë 28.5.2018, FTL sh.a., ka paraqitur në ERE kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë FTL sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:
- formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.7) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit për licencim të shoqërisë "FTL" sh.a., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti